

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7180  
E mërkurë, 8 maj 2024  
Çmimi 0.50

Rama: Kush flirtton me korrupsionin nuk ka punë me ne, por me drejtësinë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## BE-ja PLAN GJASHTË MILIARDËSH PËR BALLKANIN, KOSOVA DHE SERBIA KUSHTËZOHEN ME 'REZULTATE NË NORMALIZIM'

FAQE 4-5



Këshilli i Bashkimit Evropian (BE) ka miratuar Planin e Rritjes për vendet e Ballkanit Perëndimor i cili kap vlerën e 6 miliardë eurove. Synimi i këtij plani është përshpejtimi i

reformave dhe rritjes ekonomike në këtë rajon, derisa ato synojnë anëtarësimin në BE. Në këtë kontekst, Këshilli i BE-së ka njoftuar se për Kosovën dhe Serbinë parakusht për t'i

pranuar ndihmat do të jetë "angazhimi i tyre konstruktiv me progres të matshëm dhe rezultate të dukshme në normalizim të marrëdhënieve të tyre"

## BE-ja, AFËR FINALIZIMIT TË RAPORTIT PËR ÇËSHTJEN E MASAVE NDAJ KOSOVËS

F.3



## ANËTARËSIMI NË KIE, TAHIRI: QEVERIA TË TREGOHET E MENÇUR, MOS TA LË KOSOVËN TË IZOLUAR

F.4-5



**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



VEPRIMTARI SALI BISLIMI: RITMI MARATONIK NË VAZHDIMIN E PARABURGIMIT TË PRESIDENTIT THAÇI, I PADREJTË F.7

PËRKUJTOHET HEROI BAHRI FAZLIU: TRIM, GUXIMTAR DHE I VENDOSUR DERI NË VETËMOHIM F.7

SOT VOTOHET PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE DHE PRESIDENCIALE NË MAQEDONINË E VERIUT F.5

### EKONOMI



KURTI U BËNË THIRRJE BIZNESEVE TA VAZHDOJNË BASHKËPUNIMIN ME QEVERINË F.8

GËRXHALIU: ANASHKALIMI I EKONOMISË NGA QEVERIA AKTUALE, SHOQËTËSUES F.8

### SPORT



REALI DHE BAYERNI LUFTOJNË PËR KUALIFIKIM NË FINALEN E 'WEMBLEY'-t F.12

## Putini bën betimin si president në një ceremoni të bojkotuar nga Perëndimi

**MOSKË, 7 MAJ** - Vladimir Putini të martën për herë të pestë ka dhënë betimin e presidentit të Rusisë. Ceremonia e inaugurimit në Pallatin e Madh të Kremlinit në Moskë është bojkotuar nga shumica e vendeve perëndimore, kryesisht për shkak të luftës së tij në Ukrainë.

Të pranishëm ishin zyrtarë të lartë rusë dhe personalitete të tjera, por kanë munguar përfaqësues nga Shtetet e Bashkuara, Britania, Kanada dhe shumica e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Putini, 71 vjeç, ka qeverisur herë si president e herë si kryeministër i Rusisë që nga viti 2000. Nëse e çon deri në fund mandatin e ri 6-vjeçar, ai do ta tejkalojë udhëheqjen gati 30-vjeçare të diktatorit sovjetik Josef Stalin, për t'u bërë udhëheqësi më jetëgjatë

rus në më shumë se dy shekuj. Putini ka garuar në zgjedhjet presidenciale të marsit, duke fituar mbi 87 për qind të votave pasi kishte miratuar një sërë reformash kushtetuese në vitin 2020, të cilat i dhanë mundësinë të garonte edhe për dy mandate të tjera gjashtëvjeçare. Kjo nënkupton se ai mund të mbetet në pushtet deri në vitin 2036. Zgjedhjet ruse kontrollohen nga Kremlini dhe nuk janë as të lira e as të drejta, por qeveria i sheh të nevojshme për të përcjellë një ndjenjë legjitimiteti. "Ne sigurisht që nuk i konsideruam ato zgjedhje as të lira dhe as të drejta, por ai është president i Rusisë dhe ai do të vazhdojë në këtë cilësi", ka thënë zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Matthew Miller, përpara inaugurimit.



Zgjedhjet ishin të parat prej se Putini ka filluar pushtimin e Ukrainës fqinje në shkurt të vitit 2022. Dy kandidatë që ishin kundër kësaj lufte nuk ishin lejuar të konkurronin kundër tij për, siç u tha, çështje teknike.

Ndërkohë, armiku i tij më i madh politik, Aleksei Navalny, ka vdekur

derisa ishte në një burg në Siberi, një muaj përpara se të mbaheshin zgjedhjet. "Lufta, vrasjet politike, varfërimi i rusëve... Nuk ka prosperitet për Rusinë, nuk ka paqe dhe liri për qytetarët tanë. Vendi ynë po udhëhiqet nga një gënjeshtar, një hajdut dhe një vrasës. Por, kësaj padyshim që do

t'i vijë fundi", ka shkruar e veja e Navalny, Yulia Navalnaya, në rrjetet sociale.

Pushtimi rus i Ukrainës ka bërë që marrëdhëniet midis Moskës dhe Perëndimit të bien në nivelin më të ulët që nga fundi i Luftës së Ftohtë.

Aleatët perëndimorë të Ukrainës janë angazhuar në mbështetje të saj me armatim e logjistikë, ndërsa Rusinë e ndëshkuan me një sërë sanksionesh. Duke folur pasi ka bërë betimin, Putini ka thënë se nuk do ta përjashtonte dialogun me Perëndimin por, sipas tij, ai do të duhej të zhvillohej në "kushte të barabarta". "Ne jemi një popull i bashkuar dhe i shkëlqyeshëm. Së bashku do t'i kapërcejmë të gjitha pengesat, do t'i realizojmë të gjitha planet tona dhe do të fitojmë", ka thënë Putini.

## Hamasi pranon armëpushimin, ndërsa Izraeli nis ofensivën në Rafah

**GAZA, 7 MAJ** - Grupi militant palestinez Hamas, i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, është pajtuar me një propozim armëpushimi në Gazë, por Izraeli ka thënë se kushtet nuk i përmbushnin kërkesat e këtij shteti dhe ka vazhduar sulmet në Rafah, ndërsa planifikon vazhdimin e negociatave për një marrëveshje. Zhvillimet në luftën që ka nisur me shtatë muaj më parë kanë ardhur pasi forcat izraelite kanë goditur Rafahun në jug të Gazës dhe kanë urdhëruar banorët të largoheshin



nga pjesët e qytetit. Qyteti Rafah ka qenë një strehë për më shumë se një milion palestinezë të zhvendosur.

Hamasi ka thënë në një deklaratë të shkurtër se shefi i grupit, Ismail

Haniyeh, i kishte informuar ndërmjetësuesit e Katarit dhe Egjiptit se e pranoi propozimin e tyre për një armëpushim.

Zyra e kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu ka thënë se

propozimi i armëpushimit nuk përmbushte kërkesat e Izraelit, por shteti do të dërgonte një delegacion për t'u takuar me negociatorët për të arritur një marrëveshje.

Ministria e Jashtme e Katarit ka thënë se delegacioni i saj do të shkojë në Kajro të martën për t'i rifilluar negociatat jo të drejtpërdrejta midis Izraelit dhe Hamasit.

Në një deklaratë, zyra e Netanyahu ka theksuar se kabineti i tij i luftës ka miratuar vazhdimin e një operacioni në Rafah.

Ministri i Jashtëm i Jordanisë,

Ayman Safadi, ka thënë se duke e bombarduar Rafahun, Netanyahu është duke rrezikuar një armëpushim.

Ndërsa zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Matthew Miller, ka thënë se Uashingtoni do të diskutojë përgjigjen e Hamasit me aleatët dhe se një marrëveshje ishte "absolutisht e arritshme".

Më shumë se 34 mijë e 600 palestinezë janë vrarë në konflikt, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë. OKB-ja ka thënë se kriza e urisë në enklavë është e pashmangshme.

## Moska paralajmëron se do të godasë objektiva ushtarake britanike

**MOSKË, 7 MAJ** - Rusia ka paralajmëruar se do të godasë objektiva ushtarake britanike brenda Ukrainës dhe gjetiu, nëse forcat ukrainase godasin Rusinë me raketat me rreze të gjatë të furnizuara nga Britania. Dërgimi i këtyre raketave drejt Ukrainës është miratuar nga sekretari i Jashtëm britanik David Cameron. Gjatë një vizite në Kiev javën e kaluar, sekretari Cameron ka thënë se forcat ukrainase do të mund t'i

përdorin raketat britanike me rreze të gjatë për të goditur objektiva brenda territorit të Rusisë. "Ndërsa Rusia po godet brenda Ukrainës, mund ta kuptoni përse Ukraina ndien nevojën të sigurohet që po mbrohet", ka thënë Cameroni gjatë një interviste për agjencinë e lajmeve "Reuters" javën e kaluar. Cameroni ka thënë se Londra nuk ka vendosur parakushte për mënyrën se si do t'i përdorin forcat ukrainase armatimet e dhëna nga

Britania. Ndërsa Ministria e Jashtme e Rusisë ka njoftuar nëpërmjet një deklaratë se ka thirrur në takim ambasadorin britanik në Moskë, Nigel Casey dhe e ka paralajmëruar atë se nëse forcat ukrainase përdorin për ta goditur Rusinë armatime të furnizuara nga Britania, Moska mund të kundërpërgjigjet ndaj "çdo objekti ushtarak britanik dhe pajisjeve në territorin ukrainas apo më gjerë".



## Scholz i bën thirrje Kinës të luajë rol më të madh ndaj borxhit të vendeve të varfra



**BERLIN, 7 MAJ** - Kancelari gjerman Olaf Scholz të martën i ka bërë thirrje Kinës që të luajë një rol më të madh në ndihmën e vendeve të varfra. Ai ka thënë se këtë çështje e ka ngritur me presidentin kinez Xi Jinping gjatë udhëtimit të tij të fundit në

Pekin. "Është e qartë se Kina, si një nga kreditorët më të mëdhenj, duhet të luajë një rol më të madh në përgjithësi në mënyrë që ta zvogëlojë barrën e borxhit të vendeve më të varfra në afat të gjatë", ka thënë Scholz gjatë një fjalimi në samitin e

Zgjidhjeve Globale në Berlin. Numri i vendeve në një krizë borxhi është dyfishuar në dhjetë vitet e fundit, ka thënë kancelari gjerman. Kina është një nga kreditorët më të mëdha në botë, veçanërisht për vendet në zhvillim, falë huave masive të

infrastrukturës për to. Rritja e vështirësive financiare në vendet më të varfra po bëhet problem, veçanërisht në dritën e përpjekjeve për t'i luftuar ndryshimet klimatike, sipas kancelarit gjerman, shkruan "Reuters".

# Osmani: ShBA-ja është në ADN-në e suksesit të Kosovës

Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në kuadër të samitit ShBA-Afrikë në Teksas, ka thënë se roli amerikan ka qenë përcaktues për fatin e shtetit tonë. Në këtë kontekst, presidentja Osmani ka thënë se ShBA-ja është në ADN-në e suksesit të shtetit të Kosovës

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

TEKSAS, 7 MAJ - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në kuadër të Samitit ShBA - Afrikë, gjatë vizitës zyrtare në Teksas të ShBA-së, në eventin qendror me rastin e 20-vjetorit të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), ka paraqitur rrugëtimin e deritashëm të Kosovës, duke potencuar sukseset në të cilat ShBA-ja ka luajtur rol vendimtar. Me pjesëmarrjen e ish-presidentit George W. Bush dhe në praninë të

liderëve afrikanë, u diskutua për sukseset 20-vjeçare të punës transformuese të MCC-së.

Në sesionin special të moderuar nga senatori republikan Mike Johanns, presidentja Osmani, ndër të tjera, foli për partneritetin e jashtëzakonshëm me ShBA-në, me ç'rast potencoi në veçanti edhe bashkëpunimin e suksesshëm me MCC-në.

Presidentja Osmani ka bërë një falënderim të posaçëm për partneritetin e shkëlqyeshëm me MCC-në si dhe ka shprehur mirënjohje të thellë për leadershipin e presidentit Bush,



trashëgimia e të cilit, sipas saj, po reflektohet më së miri sot nëpërmjet punës së MCC-së. Më tutje, Osmani ka thënë se "ShBA-ja ka luajtur rol përcaktues

në procesin e pavarësimit të Kosovës".

"Bashkëpunimi ndërmjet MCC-së dhe Kosovës simbolizon progresin, ambicien dhe vizionin e përbashkët për demokraci dhe të ardhme të qëndrueshme", ka thënë Osmani. Sipas presidentes Osmani, ky partneritet është dëshmi e marrëdhënieve strategjike dhe historike ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së.

Presidentja Osmani ka potencuar se Kosova ka bërë hapa përmbytësorë në procesin e reformave të shumta, me theks të veçantë në drejtësi dhe sundim të ligjit.

Në adresimin e saj, presidentja Osmani ka folur për hapat e bërë nga Kosova në nxitjen e rritjes ekonomike dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Sipas presidentes Osmani, ka rezultate të jashtëzakonshme nga partneriteti me MCC-në, i cili ka ndihmuar që zhvillimi jo vetëm i

këtij sektori, të shkojë në drejtimin e duhur.

"Projektet ambicioze reflektojnë një vizion afatgjatë për Kosovën, duke siguruar që partneriteti ynë me MCC-në të çojë në ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme", ka theksuar presidentja Osmani.

Osmani ka theksuar se me pjesëmarrjen në këtë Samit, si dhe me ndihmën e MCC-së në vazhdimësi, janë krijuar mundësi për t'i paraqitur të arriturat e Kosovës ndër vite, por edhe për ta filluar partneritetin me shtetet afrikane. Ndërsa në një postim në "Facebook", Osmani ka shkruar se roli i ShBA-së ka qenë përcaktues për fatin e Kosovës. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se ShBA-ja është në ADN-në e suksesit të shtetit tonë. "Roli i ShBA-së ka qenë përcaktues për fatin e Kosovës, ndaj ShBA-ja është në ADN-në e suksesit të shtetit tonë", ka shkruar Osmani.



## Policia e Kosovës gjen kamera në një rrugë malore në kufirin lindor me Serbinë



PRISHTINË, 7 MAJ - Policia e Kosovës ka njoftuar se ka gjetur të hënën dy kamera me panele diellore në kufirin lindor me Serbinë, për të cilat dyshon se ishin vendosur për vëzhgimin e rrugës nga kontrabandistë të dyshuar.

Në një njoftim për medie të martën, policia ka thënë se kamerat ishin vendosur në një rrugë malore nga fshati Ranillug i Kosovës, në drejtim të fshatit Konçul të Serbisë. Policia e ka ndaluar në vendin e ngjarjes një 30-vjeçar me

shtetësi të dyfishtë: kosovarë dhe serbe. "Në vendin e lartcekur është ndaluar edhe automjeti me targa serbe me drejtues J. S., 30-vjeçar... I njëjti dyshohet se aty ka shkuar për t'u kujdesur për kamerën që veç e kishin marrë më herët njësitet policore", ka njoftuar policia. Me urdhër të prokurorit, ai është ndaluar për 48 orë, ndërsa automjeti i tij është sekuestruar.

Policia ka theksuar se i dyshuari "e kishte përdorur këtë automjet vetëm për

kontrabandë të mallrave përmes rrugëve ilegale".

Në korrik të vitit 2023 Qeveria e Kosovës mori vendim për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia, për arsye "sigurie", kur tre policë të Kosovës u arrestuan nga policia serbe.

Në dhjetor, Policia e Kosovës ka hequr qindra kamera në komunat me shumicë serbe në veri të vendit. Paraprakisht, ajo kishte hequr kamera edhe në Klokot, Partesh dhe Ranillug - komuna me shumicë serbe në jug të Lumit Ibër.

## Kurti takon Bashkim Jasharin: Ngritja dhe rritja e FSK-së është e paparë në këta më pak se dy vjet e gjysmë

PRISHTINË, 7 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka takuar të martën komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Bashkim Jashari.

Kurti ka theksuar se komandanti i FSK-së, gjeneraljejtënant Bashkim Jashari, ende nuk e ka prekur gjysmën e mandatit, por ngritja dhe rritja e FSK-së

është e paparë në këta më pak se dy vjet e gjysmë. "Biseduam gjatë mbremë për të arriturat e deritashme, gjendjen aktuale dhe sfidat e ardhshme. Forcimi e zgjerimi i ushtrisë

sonë me buxhet të dyfishuar, armatim të trefishuar dhe katërfishim të trajnimeve jashtë vendit është rruga e sigurt drejt NATO-s", ka shkruar Kurti në "Facebook".



# BE-ja plan gjashtë miliardësh për Ballkanin, Kosova dhe Serbia kushtëzohen me 'rezultate në normalizim'

Këshilli i Bashkimit Evropian (BE) ka miratuar Planin e Rritjes për vendet e Ballkanit Perëndimor i cili kap vlerën e 6 miliardë eurove. Synimi i këtij plani është përshpejtimi i reformave dhe rritjes ekonomike në këtë rajon, derisa ato synojnë anëtarësimin në BE. Në këtë kontekst, Këshilli i BE-së ka njoftuar se për Kosovën dhe Serbinë parakusht për t'i pranuar ndihmat do të jetë "angazhimi i tyre konstruktiv me progres të matshëm dhe rezultate të dukshme në normalizim të marrëdhënieve të tyre"

**BRUKSEL, 7 MAJ** - Këshilli i Bashkimit Evropian (BE) ka miratuar Planin e Rritjes për vendet e Ballkanit Perëndimor, një instrument i ri për t'i mbështetur reformat e lidhura me BE-në dhe rritjen ekonomike në rajon. Me këtë miratim kanë përfunduar të gjitha procedurat dhe vendimi hyn në fuqi menjëherë pas publikimit në gazetën zyrtare të BE-së. Pas kësaj, vendet nga Ballkani Perëndimor do të ftohen t'i paraqesin Komisionit Evropian agjendat e tyre të reformave, duke paraqitur reformat socio-ekonomike dhe themelore që planifikojnë të ndërmarrin në tre vjetët e ardhshëm.

Vendet anëtare të BE-së do ta kenë fjalën kryesore në miratimin e burimeve financiare. Pagesat do të bëhen dy herë në vit, me kusht që shtetet t'i përmbushin hapat cilësorë dhe sasiorë të specifikuar në agjendat e tyre të reformave.

Kur parakushtet për mbështetje nuk plotësohen ose nuk plotësohen më, BE-ja mund të vendosë ta pezullojë lirin e fondeve.

## Qëllimi i Planit të Rritjes për rajonin

Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor do ta mbulojë periudhën midis vitit 2024 dhe 2027. Plani i Rritjes arrin shumë prej gjashtë miliardë eurosh për vendet e rajonit. Nga kjo shumë, dy miliardë janë në formë granti, ndërsa katër miliardë euro janë në formë kredie me këste shumë të favorshme.

Në deklaratën e lëshuar nga Këshilli i BE-së është theksuar se qëllimi kryesor është mbështetja për harmonizimin e partnerëve nga Ballkani Perëndimor me vlerat, ligjet, rregullat, standardet, politikat dhe praktikatat e BE-së, me qëllim të anëtarësimit të ardhshëm në BE, si dhe integrimi progresiv i



tyre në një treg të vetëm evropian, si dhe konvergencën socio-ekonomike me BE-në. Burimet financiare janë planifikuar për të mbështetur një sërë reformash socio-ekonomike dhe themelore, duke përfshirë reformat që lidhen me sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore.

## Ndihma financiare nuk është e pakushtëzuar

Për të marrë mbështetje në kuadër të këtyre instrumenteve, vendet e rajonit duhet të përgatisin një agjendë reformash, duke theksuar reformat që planifikojnë të ndërmarrin për t'i arritur qëllimet. Vëmendje e veçantë duhet t'i

kushtohet mënyrës sesi vendet e Ballkanit Perëndimor do të kontribuojnë në përafrimin progresiv dhe të vazhdueshëm me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së. Parakushtet e përgjithshme për mbështetjen e BE-së sipas Planit të Rritjes përfshijnë mbështetjen dhe respektimin e vazhdueshëm për mekanizmat efektivë demokratikë, duke përfshirë një sistem parlamentar shumëpartiak, zgjedhje të lira dhe të ndershme, media pluraliste, një gjyqësor të pavarur dhe sundim të ligjit, si dhe garantimin e respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e pakicave. Kosova dhe Serbia kanë edhe një kusht, që ka të bëjë me normalizimin e marrëdhënieve. Sipas vendimit të miratuar, në

mënyrë që këto dy vende të përfitojnë nga Plani i Rritjes, ato duhet të angazhohen në mënyrë konstruktive "me progres të matshëm dhe rezultate të prekshme" në normalizimin e marrëdhënieve të tyre me qëllim zbatimin e plotë të të gjitha detyrimeve që dalin nga marrëveshja për rrugën drejt normalizimit dhe aneksi i zbatimit, si dhe të gjitha marrëveshjet e mëparshme për dialogun dhe t'u bashkohet negociatave për marrëveshjen gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve. "Ndihma do të jetë mbështetje për një sërë reformash socio-ekonomike, përfshirë reformat e lidhura me sundim të ligjit dhe të drejtave fundamentale", ka njoftuar Këshilli i BE-së.

## Anëtarësimi në KiE, Tahiri: Qeveria të tregohet e mençur, mos ta lerë Kosovën të izoluar

**PRISHTINË, 7 MAJ** - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, duke folur për procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës (KiE), ku vendet perëndimore, posaçërisht Franca dhe Gjermania, për t'u realizuar kjo, janë duke kërkuar nga qeveria përparim në themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ka uruar që qeveria e drejtuar nga Albin Kurti të tregohet e mençur në këtë drejtim, në mënyrë që mos ta izolojë vendin.

Tahiri ka thënë se qeveritë e kaluara asnjëherë nuk e kanë lënë Kosovën të izoluar. "Uroj që qeveria jonë të jetë e

mençur dhe mos ta lerë Kosovën të izoluar nga Evropa... Vendime të vështira kemi pasur edhe në qeveritë e kaluara, por nuk e kemi lënë Kosovën të izoluar, edhe pse kompromiset na kanë kushtuar me humbjen e pushtetit, por ne kemi venë shtetin para dhe jo pushtetin...", ka shkruar Tahiri në "Facebook".

Të hënën kryeministri Albin Kurti është takuar me ambasadorët e vendeve të Quintit me të cilët ka biseduar rreth anëtarësimit në KiE. Duke iu referuar kërkesës për themelimin e Asociacionit, Kurti citohet të ketë thënë se normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë dhe anëtarësimi në KiE nuk duhet të përzihen.



# Sot votohet për zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale në Maqedoninë e Veriut

**SHKUP, 7 MAJ** - Në Maqedoninë e Veriut sot (e mërkurë) mbahen dy palë zgjedhje: raundi i dytë i zgjedhjeve presidenciale, si dhe zgjedhjet parlamentare. Ato do t'i hapin rrugë formimit të qeverisë së re nga partia fituese, e cila do të arrijë të sigurojë 61 votat e nevojshme për formimin e ekzekutivit të ri.

Dilema mbetet nëse të mërkurën do të arrihet të zgjidhet presidenti i shtetit, pasi ka një prag zgjedhor prej 40-përqindësh të daljes në votime. Bazuar në raundin e parë të zgjedhjeve më 24 prill, kur në garë ishin shtatë kandidatë, në zgjedhje patën dalë rreth 49 për qind e 1.8 milion qytetarëve me të drejtë vote. Në garë janë dy kandidatë: fituesja e raundit të parë, Gordana Silanovska-

Davkova, që ka fituar 363 000 vota dhe presidenti aktual Stevo Pendarovski, me 180 mijë vota.

Që të zgjidhet presidenti i ri, në zgjedhje duhet të dalin rreth 750 000 votues, apo në zgjedhje të dalin votuesit e kandidatëve që u eliminuan në raundin e parë. Por, deri tani asnjëri prej tyre nuk ka dalë publikisht t'u bëjë thirrje votuesve të tyre që të dalin në zgjedhje duke ngritur dilemën nëse zgjedhjet do ta arrijnë pragun kushtetues. Nga kandidatët shqiptarë, më shumë vota në raundin e parë mori Bujar Osmani nga Fronti Evropian i kryesuar nga Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI), gjithsej 120 000 vota. Ndërsa Arben Taravari nga koalicioni opozitar VLEN mori 83 mijë vota. BDI-ja publikisht



nuk ka dalë me qëndrim nëse do ta mbështesë ndonjërin kandidat apo do të bëjë ftesë për bojkot, por eksponentë të saj në rrjetet sociale në vazhdimësi kanë bërë thirrje që më 8 maj të

bojkotohen zgjedhjet presidenciale. Edhe nga koalicioni VLEN nuk kanë bërë thirrje për dalje në votime për zgjedhjen e presidentit, por bazuar në

qëndrimet e drejtuesve të saj, dhe takimit të 6 majit të Arben Taravarit me kreun e VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickoski, si dhe qëndrimeve të eksponentëve të saj në rrjetet sociale, atëherë votuesit e saj mund të dalin në votime për zgjedhjen e presidentit. Por, që zgjedhjet të mos dështojnë, nevojitet që në zgjedhje të dalin edhe anëtarët e katër kandidatëve të tjerë, në veçanti të Maksim Dimitrievskit, i cili ka arritur të fitojë rreth 84 000 vota. Nëse zgjedhjet dështojnë, atëherë mandatin partisë fituese të zgjedhjeve parlamentare do t'ia ndajë kryetari në detyrë i Kuvendit, Jovan Mitrevski, më pas të nisnin procedurat për zgjedhje të reja presidenciale.

## Rama: Kush flirton me korrupsionin nuk ka punë me ne, por me drejtësinë

**TRANË, 7 MAJ** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në fjalën e tij gjatë mbledhjes së përbashkët e të hapur në mes të grupit parlamentar të Partisë Socialiste (PS) dhe kabinetit qeveritar, ka pasur një paralajmërim për socialistët: "kush korruptohet nuk ka punë me ne". Sipas tij, PS-ja është e vetmja forcë që ka bërë një zgjedhje të paguxuar nga askush më parë për t'u vendosur në anën e drejtësisë dhe në dispozicion të drejtësisë.

"Prandaj, ministri, deputeti, kryetari i bashkisë, drejtori apo kushdo që flirton me korrupsionin, nuk është yni dhe nuk ka punë më me ne", ka thënë Rama.

Për Ramën këto figura janë tradhtarë të dyfishtë. "Çdo anëtar i Partisë Socialiste që bën korrupsion është tradhtar i shoqërisë", ka thënë Rama.

Kryeministri Rama është shprehur se ata që kanë rezultuar të korrumpuar kanë qenë një mollë e kalbur dhe se vetëm duhet ta vijoje luftën me drejtësinë.

"Kur dëgjoj që thonë se Rama e ka



hedhur si limon të shtrydhur se si duhet më, e kanë gabim. Është një mollë e kalbur që bie vetë", ka thënë Rama.

Numri një i qeverisë e ka bërë të qartë se nuk do të bëhet kurrë mburojë e ndonjë zyrtari socialist të korrumpuar dhe që ka probleme me drejtësinë.

"Unë nuk lëshoj vetëm djalin e vogël kur do të hidhet nga një shkëmb për në det, por nuk mund të mbaj asnjë burrë me para të

vjedhura", ka deklaruar Rama. Në fjalën e tij hapëse Rama ka zgjedhur ta krahasojë situatën e vendit para se socialistët ta merrnin pushtetin dhe pas kësaj. Për kryeministrin tashmë ka dy pasqyra të ndryshme të faqes së Shqipërisë.

Rama ka sjellë në vëmendje se kur shqiptarët i votuan, vendi ishte në pikën më të ulët, rendi publik ishte përtokë, me qindra vrasjet dhe mijëra aksidente.

"Krimi kishte fituar lojën me shtetin, vjedhjet e shtëpive ishin të përditshme dhe banorët kërkonin siguri". Sipas Ramës, asokohe asgjë nuk ishte funksionale, që nga spitalet, universitetet, punësimet e deri tek institucionet e drejtësisë.

"Çdo familje shqiptare e ka jetuar dhe e ka të qartë se kjo ishte pasqyra e një dekade më parë", ka thënë Rama.

Ai ka kujtuar se si protestat kishin mbështetur vetëm punën e PS-së. "Protestuesit e vrarë nga dyert e shtetit trajtoheshin si kriminelë që kishin marrë thjesht atë që meritonin, kurse për drejtësinë vrasjet ishin gabime teknike", ka thënë Rama referuar dukshëm ngjarjes së 21 janarit. Sipas tij, sot pasqyra është krejtësisht tjetër dhe për këtë nuk ka dyshime.

Numri një i qeverisë ka thënë se Partia Socialiste është në luftë për ta bërë Shqipërinë një shtet real, ku sundimi i ligjit ta arrijë nivelin e kërkuar nga Bashkimi Evropian. Rama ka thënë se lufta kundër korrupsionit ka nisur me reforma, "kur ne nisëm përpjekjen për

reformën në drejtësi".

"Kjo luftë deri këtu nuk është zhvilluar as pa gabime, as pa dështime, as pa zhgënjime. Deri këtu ne kemi bërë shumë dhe kemi arritur jo pak. Këtë e thotë hapja e negociatave", është shprehur Rama.

Kryeministri Rama ka thënë se nuk do të hapeshin negociatat nëse Shqipëria nuk do të kishte ndryshuar si dita me natën.

"Askush më parë, asnjë forcë me peshë që prej shpëputjes së Shqipërisë nga perandoria otomane, nuk i ka hyrë detit në këmbë për ta pavarësuar drejtësinë nga pushteti politik. Askush dhe asnjë", ka thënë Rama, duke shtuar se "nuk po thotë se ne e kemi mundur korrupsionin, por jemi në mes të një lufte reale me korrupsionin".

"Ka një të vërtetë të madhe në këtë mes. Drejtësia është e ndarë nga politika. Ne jemi e para parti politike që kemi dorëzuar një armë me të cilën të gjithë të tjerët janë mbrojtur me drejtësinë duke vrarë drejtësinë. Ne jemi çarmatosur", ka thënë Rama.

## BE-ja, afër finalizimit të raportit për çështjen e masave ndaj Kosovës

**BRUKSEL, 7 MAJ** - Nga Bashkimi Evropian (BE) kanë folur sërish për çështjen e heqjes apo jo të masave ndëshkuese ndaj Kosovës.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka deklaruar të martën se Brukseli e ka bërë të qartë se Këshilli Evropian do të diskutojë rreth çështjes së largimit të tyre, varësisht prej zhvillimeve në terren.

"Mesazhi i Këshillit Evropian

në dhjetor, edhe kur u vendosën masat, ka qenë shumë i qartë, se Këshilli do të diskutojë për heqjen e mundshme të masave të BE-së në varësi të zhvillimeve në terren në bazë të raportit të përfaqësuesit të lartë rreth përmbushjes së kërkesave të BE-së që iu kërkuan Kosovës", ka thënë Stano.

Ai ka shtuar se mund ta konfirmojë se raporti është afër finalizimit, mirëpo nuk

ka treguar kohën se kur do t'i dorëzohet Këshillit Evropian.

"Unë mund të konfirmoj, pa diskutuar në publik, vijueshmërinë e procesit në Këshill. Mund të konfirmoj që raporti është afër finalizimit dhe eventualisht të dorëzohet te Këshilli Evropian. Lidhur me përmbajtjen s'mund të komentoj sepse këto janë procedura brenda Këshillit", ka thënë Stano.



## Policia sekuestron 40 motoçikleta në Pejë

PEJË, 7 MAJ - 40 motoçikleta ka sekuestruar policia në qytetin e Pejës. Sipas njoftimit të policisë, sekustrimi është bërë më 4 dhe 5 maj.

Gjatë datave të lartcekura njësitet e DRP Pejë ka sekuestruar 40 motoçikleta të llojeve të ndryshme, ndërsa për

kundërvajtësit janë lëshuar fletëgjyba për kundërvajtjet: mosposedimi i lejes për vozitje, mosposedimi i kategorisë përkatëse, ngasje e mjetit pa regjistrim dhe kundërvajtje të tjera.

“Aktivitetet dhe detyrat e shumta policore, që janë të planifikuara

në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë, do të vazhdojnë në mënyrë intensive në ditët në vijim, pa asnjë tolerim ndaj secilit kundërvajtës, në të mirë të rregullimit të komunikacionit dhe parandalimit të aksidenteve”, ka njoftuar policia.



## Qeveria e Kosovës merr vendim për pajisjen e serbëve me patentë shoferë RKS

PRISHTINË, 7 MAJ - Qeveria e Kosovës ka njoftuar se Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka nxjerrë vendimin që u mundëson qytetarëve kalimin nga patentë-shoferët e lëshuar nga institucionet jolegale serbe në Kosovë, në ato zyrtare të lëshuara nga institucionet e Republikës së Kosovës.

“Një kohë të gjatë kemi pranuar kërkesat tuaja për marrjen e një vendimi të këtillë. Ne duam t’ua lehtësojmë qytetarëve tanë problemet e përditshme me të cilat ballafaqohen. Kalimi në patentë shofer të Republikës së Kosovës mundëson regjistrimin e lehtë dhe praktik të automjeteve”, ka thënë Kurti në një video-adresim në gjuhën serbe.

MPB-ja ka bërë me dije se kalimi në patentë shofer RKS nuk kërkon përsëritje të dhënies së provimit për fitim të patentës së shoferit, “por vetëm aplikim të cilin çdo qytetar duhet ta dorëzojë në Qendrën për Pajisje me Dokumente”.

Dokumentet që duhen përfshirë në aplikim, sipas MPB-së, janë



letërnjoftimi, origjinali i patentë shoferit të lëshuar nga ana e autoriteteve serbe, certifikata e gjendjes shëndetësore për pajisje

me patentë shofer, dëshmi të pagesës së taksës dhe origjinali i patentë shoferit të lëshuar nga UNMIK-u apo RKS “në qoftë se

bëhet aplikimi për shtimin e kategorive, e cila është mundësuar përmes këtij vendimi të Ministrisë së Punëve

të Brendshme”.

Autoritetet e Kosovës kanë njoftuar se ky vendim hyn në fuqi më 9 maj dhe është i vlefshëm deri më 9 gusht 2024.

Ditë më parë Bashkimi Evropian ka theksuar se mbetet në qëndrimin e shprehur më herët se në Kosovë mbështet vetëm një strukturë të vetme institucionale dhe administrative sipas kornizës ligjore të Kosovës. Por, në të njëjtën kohë, blloku është shprehur se çështja e institucioneve që mbështeten nga Serbia duhet të zgjidhet përmes themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Çështja e institucioneve serbe në Kosovë u ngrit gjatë takimit të fundit të kryenegociatorëve të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel më 25 prill, kur u diskutua për çështjen e dinarit serb.

Gjatë takimit pala serbe ka kërkuar që të gjitha institucionet serbe, që Kosova i konsideron ilegale, të vazhdojnë të financohen nga Beogradi deri në kohën kur të krijohet Asociacioni.

## Zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës lirohen nga akuza për keqpërdorim detyre



PRISHTINË, 7 MAJ - Gjykata Themelore në Prishtinë ka liruar nga akuza ish-sekretarin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe tre zyrtarë të tjerë të kësaj ministrie që akuzoheshin për keqpërdorim detyre.

Ish-sekretari Betim Reçica, e zyrtarët Isa Berisha, Mirdit Emini dhe Leonora Limani, akuzoheshin për përzgjedhje të operatorëve ekonomikë që nuk i kishin ofertat më të lira për tenderin e autostradës së Gjilanit. Reçica akuzohej se si ish-ushtues i detyrës së drejtorit të Prokurimit ka ushtruar presion mbi anëtarët e komisionit

vlerësues për ta bërë një raport brenda 10 ditësh në favor të kompanisë “Gjoka Konstruktion”, e më pas i kishte ndryshuar raportet e komisionit vlerësues duke e shpallur atë kompani fituese.

Mbi të rëndonin edhe akuzat për shpëlarje parash, dhe dyshohej se me para me prejardhje kriminale, me qëllim të fshehjes së tyre, e ka blerë një veturë sportive “Audi” duke e lënë në emër të të vëllait. Mbi Berishën, Eminin e Limanin rëndonin akuzat e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, pasi dyshohej se nuk zgjodhën operatorët më të lirë.

## Ndërtimi i urës mbi lumin Sitnica në Lipjan, nënshkruhet memorandumi në vlerë 370 mijë euro

LIPJAN, 7 MAJ - Ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka bërë me dije se ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me

kryetarin e komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti. Memorandumi përfshin ndërtimin e urës mbi lumin Sitnica dhe kap vlerën e 370

mijë eurove. “Sapo nënshkruam memorandumin e mirëkuptimit me Komunën e Lipjanit, të cilën komunë po e financojmë me 370 mijë euro.

Përmes këtij Memorandumi po e bëjmë financimin e projektit të rëndësishëm: Ndërtimi i Urës mbi Lumin Sitnica”, ka shkruar Aliu në “Facebook”.



## Veprimtari Sali Bislimi: Ritmi maratonik në vazhdimin e paraburgimit të presidentit Thaçi, i padrejtë

PRISHTINË, 7 MAJ - Veprimtari Sali Bislimi, i cili jeton dhe vepron në Zvicër, ka shkruar një shkrim për Gjykatën Speciale. Ai ka shkruar në "Facebook" se Gjykata Speciale zhvillon imagjinatën mbi të cilën është krijuar dhe jo drejtësinë. "Ritmi

maratonik në vazhdimin e paraburgimit të presidentit Thaçi është i padrejtë. Mbajtja e gjatë në paraburgim është sinonim i një dënimi të maskuar, me këto dukuri gjykata humb kredibilitetin dhe paanshmërinë. Kosova duhet

të ngritët dhe të afirmohet", ka shkruar ai. Sali Bislimi ka thënë se ish-presidenti Thaçi meriton mbrojtjen në liri me garancitë e duhura sipas neneve 67.1 dhe 60.4 të statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare.



## Përkujtohet heroi Bahri Fazliu: Trim, guximtar dhe i vendosur deri në vetëmohim

PRISHTINË, 7 MAJ - Janë bërë 26 vjet nga rënia heroike e heroit Bahri Fazliu. Ai të martën është kujtuar nga familjarët, bashkëluftëtarët dhe përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pasi ka bërë homazhe te varri i Bahri Fazliut, ka thënë se ai kishte rënë heroikisht në një ballafaqim të rreptë me forcat serbe. "Sot më 7 maj janë mbushur 26 vjet nga rënia heroike e dëshmorit të kombit, Bahri Fazliu – Gëzimit. Ai u vra në betejë, ballafaqim me forcat armike serbe në vendin i cili ndodhet në kufi të Kosovës edhe me Shqipërinë edhe me Malin e

Zi. Pra një vend domethënës i cili është në përputhje edhe me idealin e Bahri Fazliut, për çlirim e bashkim kombëtar. Bahri Fazliu është jo vetëm dëshmor i kombit, por edhe veprimtar, artist këngëtar poet i cili ka lënë shumë shkrime, poezi të cilave nuk ju mbaron aktualiteti sepse ato tregojnë qysh liria është më e vlefshme më e shtrenjtë se jeta kundër padrejtësive dhe robërisë së okupatorëve", ka thënë kryeministri Kurti.

Më tutje, Kurti ka shtuar se nuk do ta harrojnë asnjëherë kontributin e dëshmorëve të kombit për lirinë e Kosovës. "Andaj edhe sot me

bashkëpunëtorët e Bahri Fazliut, me familjarët e tij me ministra, qytetarë e aktivistë vijmë dhe bëjmë nderime këtu duke mos harruar asnjëherë se punën më të madhe më të rëndë më të vështirë e kanë kryer dëshmorët e kombit. Edhe ne e kemi shumë të rëndësishme, por këto janë gjë e vogël, gjithsesi në rrugën të cilën e kanë shtruar me gjakun e tyre dhe prej nga ne sot e kemi lirinë", ka thënë Kurti.

Heroi Bahri Fazliu është përkujtuar edhe nga lideri i AAK-së dhe ish-komandanti i UÇK-së në Dukagjin, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se Bahri Fazliu është një prej figurave më të ndritura



të Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës. "Trim, guximtar e i vendosur deri në vetëmohim, Bahri Fazliu, 26 vjet më parë fitoi përjetësinë, duke u bërë shembull për rininë shqiptare, se si duhet Atdheu dhe si sakrifkohet për të. Lavdi veprës dhe rënies heroike të Bahri Fazliut. Përgjithmonë në kujtesën tonë historike!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Më 7 maj të vitit 1998, në vendin e quajtur Bogiqe, në trekëndëshin kufitar shqiptar Mali i Zi - Kosovë

- Shqipëri, ka rënë heroikisht Bahri Fazliu. Bahri Fazliu ishte themelues i LKÇK-së dhe pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Për disa vjet kishte jetuar në ilegalitet dhe ishte kryeredaktor i revistës "Çlirimi" e cila botohej nga LKÇK-ja.

Bahriu ishte vëlla i heroit Fahri Fazliu, i cili më 2 nëntor 1989, së bashku me Afrim Zhitinë, kishin rënë heroikisht në një betejë me policinë serbe në lagjen "Bregu i Diellit" në Prishtinë.

## Haradinaj në Gjakovë kujton betejën e Çabratit: Krenar që kisha në krah bashkëluftëtarë si heronjtë gjakovarë

GJAKOVË, 7 MAJ - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kujtuar betejën e Çabratit në përvjetorin e saj. Haradinaj ka thënë se në luftën çlirimtare Gjakova ka dhënë shumë djem dhe vajza. "Gjakova, vatër e atdhedashurisë dhe shqiptarisë ndër breza, i fali shumë lirisë së Atdheut. Në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, anembanë vendit, Gjakova dha

luftëtarë të mëdhenj. Djemtë e vashat e Gjakovës ishin shembulli më i mirë i luftëtarëve të lirisë që nga mobilizimi e deri te dita e fitores", ka thënë Haradinaj.

Haradinaj ka shtuar se shpirti liridashës e atdhetar i Gjakovës nuk u shua asnjëherë.

"Gjatë luftës për liri në këtë trevë u shkatërruan shumë ekonomi familjare; e shumë vëllezër e motra tona pësuan nga dora e agresorit,

por shpirti liridashës e atdhetar i Gjakovës nuk u shua asnjëherë. Sot në kujtim të Betejës së Çabratit, me kryetarin Ardian Gjini, kolegë e familjarë, nderuam heroizmin e Brigadës 137 'Gjakova' dhe trimat që ranë. Përgjithmonë krenarë që kisha në krah bashkëluftëtarë si Heronjtë gjakovarë që i kujtuam sot. Përgjithmonë krenarë me heroizmin dhe mirënjohës për sakrificën e popullit tonë për liri", është shprehur Haradinaj.



## Mbi 1 milion e 200 mijë qytetarë janë regjistruar deri më tash në Kosovë



PRISHTINË, 7 MAJ - Mbi 1 milion e 200 mijë qytetarë janë regjistruar deri më tash. Lajmin e ka dhënë Avni Kastrati, ushtrues i detyrës së kryeshefit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK). “Në përgjithësi projekti për regjistrimin e popullsisë është duke iu ofruar fundit dhe nuk kemi probleme të aspektit në

terren. Njëkohësisht nuk kemi refuzime të mëdha të qytetarëve. Edhe ato pak, pas diskutimeve, po i pranojnë si një e mirë publike. Edhe pajisjet janë duke funksionuar dhe nuk kemi telashe në terren”, ka thënë Kastrati në një konferencë për medie të martën. Ai ka thënë se disa komuna kanë qenë shumë

aktive dhe disa nuk janë angazhuar aq. “Deri më tani po i shihni të dhënat ku janë regjistruar mbi 1 204 560 dhe regjistrimi është duke shkuar sipas planit. Edhe komunitetet, të gjitha janë duke marrë pjesë. Në disa komuna në veri nga serbët ka ende hezitim. Një pjesë e tyre po regjistrohet”, ka thënë ai.

## Kurti u bënë thirrje bizneseve ta vazhdojnë bashkëpunimin me qeverinë

PRISHTINË, 7 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u ka bërë thirrje bizneseve ta forcojnë edhe më tutje bashkëpunimin me qeverinë. Ai ka thënë të martën se qeveria e suksesshme e ndihmon sektorin privat e, sipas tij, konkurrenshëmëria ekonomike “do të sjellë prosperitet dhe mirëqenie”. “Kur një afarist ekonomik dhe një zyrtar publik ulen për një diskutim, ata të dy kanë vështrim në gjëra të ndryshme. Afaristi është i interesuar për fitim në fund, ndërsa zyrtari publik doemos për politikën në sektorin e biznesit. Është një rikujtim i mirë që në mund ta mësojmë nga njëri-tjetri. Është thelbësore të kuptojmë se si një dialog publiko-privat mund ta transformojë ekonominë tonë”, ka thënë Kurti gjatë takimit në Këshillin Kombëtar për Ekonomi dhe Investime.

Kurti si kryetar i këtij këshilli ka thënë se janë identifikuar 6 miliardë investime nga BE-ja në

infrastrukturë të re dhe për ta përmirësuar atë aktualen. “Me kalimin e kohës ne do ta bashkërendisim dialogun tonë në mënyrë që qeveria dhe sektori privat të kenë qartësi se si ta përmirësojmë të bërit biznes. Një dialog i fuqishëm publiko-privat forcon besimin ndërmjet sektorit privat dhe publik. Besimi është armatura në themelin tonë ekonomik. Përmes dialogut ne identifikojmë mundësitë e sektorit privat. U bëj thirrje bizneseve ta vazhdojnë bashkëpunimin me qeverinë. Ne po lëvizim për ta hequr licencën e eksportit për produkte farmaceutike - një pengesë kjo jotarifore që vështirëson biznesin për shumë vjet me radhë”, ka thënë ai.

Ndërsa zëvendëskryeministri Besnik Bislimi ka folur për fondin që ndahet për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ai ka thënë se Kosova mund të përfitojë 945 milionë euro. Në anën tjetër, ministria e



Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka paraqitur projektet që kjo ministri ka ndërmarrë në kuadër të energjisë. “Së pari dua të filloj të flas për skemat që i kemi pasur gjatë muajit të fundit për efikasitet të energjisë. Në fund të vitit të kaluar kemi hapur skemën për subvencionim të pajisjeve eficientet

për ngrohje për biznese. Kemi pasur mbi 100 aplikime dhe rreth 30 për qind të përfituesve kanë qenë pronarë të bizneseve gra. Më 6 shkurt kemi shpallur thirrjen për mbështetjen e konsumatorëve familjarë, por edhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për investime në sisteme të energjisë

së ripërtërishtme. Skema të financuara këto nga BE-ja, thirrjet janë të hapura ende dhe granti mund të arrijë deri 6 mijë euro, varësisht nga madhësia e sistemit dhe ju inkurajoj t'i përcillni informatat dhe t'i inkurajoni bizneset të aplikojnë”, është shprehur Rizvanolli.

## Gërxfhaliu: Anashkalimi i ekonomisë nga qeveria aktuale, shqetësues

PRISHTINË, 7 MAJ - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxfhaliu, ka thënë se ekonomia duhet të jetë në fokus dhe prioritet i qeverisë aktuale.

Ai ka shprehur shqetësimin se agjenda politike dhe dialogu i stërzgatur me Serbinë po e qesin në rend të dytë rëndësinë që duhet të ketë zhvillimi ekonomik. “Shqetësimi më i madh që e ka kapluar Kosovën, por edhe brenga më e madhe e neve si njohës të ekonomisë është anashkalimi i rëndësisë së ekonomisë nga institucionet aktuale. Duhet të kuptohet se rëndësia ekonomike duhet të jetë



më prioritet sesa ajo politike”, ka thënë Gërxfhaliu, duke shtuar se përfshirja e politikës është duke i penguar shumë procese

zhvillimore. “Është e vërtetë që në këtë kohë në Kosovë s'mund të flitet pa ngjyra politike dhe kjo, ndoshta, përfshirja e politikës

dhe ekonomisë, po i ngadalëson shumë procese të rëndësishme ekonomike sepse vetëm përmes një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm Kosova mund të ketë stabilitet social, mund të ketë indikatorë të rëndësishëm ekonomik që janë në funksion të qëndrueshmërisë ekonomike dhe edhe stabiliteti politik varet nga zhvillimi ekonomik. Andaj besoj se ekonomia duhet të jetë në fokus dhe prioritet në qeverinë aktuale sepse në qoftë se edhe më tutje do të tentojmë të jemi të barabartë me varfëri, do të jemi një shtet i varur nga importi dhe paraja e gatshme në Kosovë do të jetë gjithmonë e

eksportuar. Definitivisht ardhmëria do të jetë e zymtë dhe këtë nuk e meritojnë qytetari dhe Republika e Kosovës”, ka thënë Gërxfhaliu për “Ekonomia Online”.

Eksperti i ekonomisë ka thënë se fakti se ka një agjendë politike dhe mosarritja e një ujdje për zgjidhje të këtij problemi sot Kosova është e ndëshkuar nga BE-ja.

Gërxfhaliu ka theksuar se duhet një rimëkëmbje qoftë në aspektin diplomatik, ekonomik, promovues, sundim të rendit të ligjit në mënyrë që Kosovës t'i kthehet reputacioni të cilin e ka pasur dhe duhet ta ketë.

## Më 14 maj mbahet ankandi i gjashtë i letrave me vlerë për vitin 2024, vlera 20 milionë euro

PRISHTINË, 7 MAJ - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 14 maj 2024 do të mbahet ankandi i gjashtë për vitin 2024. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me

maturitet pesëvjeçar në shumën prej 20 milionë eurosh.

Në njoftimin e kësaj ministrie është thënë se “investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për

borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohej për të gjithë kohëzgjatjen (5 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi”.

“Për detaje rreth pjesëmarrjes

në ankande për blerjen e letrave me vlerë duhet ta kontaktoni ndonjërin nga Bankat Komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës”, ka njoftuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.





# ALI AHMETI, UNË GJENERAL MALIQ NDRECA, JAM ME TY



## Maliq NDRECA

Unë Gjeneral Maliq Ndreca, jam me Ty Ali Ahmeti, por jam edhe me të gjithë ata, me të cilët je Ti. Unë Gjeneral Maliq Ndreca, nuk jam e nuk mund të jem kurrë me ata, të cilët nuk janë me Ty Ali

Ahmeti, por përkundrazi jam e do të jem kundër tyre.

Unë Gjeneral Maliq Ndreca, jam me ata të cilët të ndihmojnë dhe të përkrahin fuqishëm Ty Ali Ahmeti, por edhe jam kundër atyre që janë kundër dhe e dëmtojnë Ali Ahmetin, në rrugën e Tij drejt integritit të Maqedonisë së Veriut

në Bashkimin European.

Nuk mund të thuash nuk dua Ali Ahmetin, por e dua Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, ani pse atë e ka themeluar edhe Ali Ahmeti dhe ka qenë Kryekomandant i saj. Ali Ahmeti, unë Gjeneral Maliq Ndreca jam me Ty, jam me partinë Tënde BDI dhe jam me Frontin

European e kundër Rosisë, ashtu sikur kam qenë me Ty, gjatë gjithë luftës së armatosur ushtarake çlirimtare në Maqedoninë e Veriut.

Jam me të gjithë ata që Ti i don, me ata që Ti i mbronë dhe me të gjithë ata që i përkrahë Ti.

I dashur Komandanti im Ali

Ahmeti, Ty dhe koalicionit Tënd Fronti European, ju uroj fitore dhe i thërras të gjithë ushtarët e mi që ishim të rreshtuar dikur në UÇK, invalidët, veteranët dhe familjet e tyre, që votën e tyre, të ia japin vetëm Ali Ahmetit dhe aleatëve të Tij në nr. 4.

Gjakovë, 07.05.2024



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Peja për herë të shtatë fiton titullin

**PEJË, 7 MAJ** - KV Peja i ka dhënë fund serisë së finaleve në Superligën A të voleybollit duke e fituar edhe ndeshjen e tretë. Para rreth 1 000 spektatorëve në "Karagaçi" të Pejës, skuadra verdhezi shënoi fitore prej 3:0 (30:28; 25:22; 25:21), duke e dominuar takimin me Skënderbeun. Pavarësisht prej

rivalitetit të madh në setin e parë, në të cilin u shënuan 58 pikë, Peja tregoi vendosmëri ta mbyllte dramën e titullit, qysh në ndeshjen e tretë. Vendasit, përkundër luhatjeve në rezultat, arritën ta ruanin fokusin, drejt qëllimit të tyre, skuadrës finaliste, KV Skënderbeu, medaljet e

argjendta u ndanë nga sekretari i përgjithshëm i FVK-së Valon Nikqi dhe anëtarë i bordit Abedin Mehani. Medaljet e arta për KV Peja u dorëzuan nga nënkryetari i Pejës, Fatmir Asllani dhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Rexhep Kurtbogaj. Kupa kapitenit Agron Nikqi iu

dorëzua nga presidenti i FVK-së, Bahri Gjinovci. Ky ishte titulli i shtatë i kampionit për KV Peja, njëherësh i katërti radhazi. FVK-ja e përgëzon KV Peja për suksesin e arritur, duke e fituar trofeun e katërt sivjet, pas Kupës së Republikës, Kupës Pavarësia dhe Kupës së Federatës.



# Reali dhe Bayerni luftojnë për kualifikim në finalen e 'Wembley'-t

### "Epoka e re"

**MADRID, 7 MAJ** - Real Madridi dhe Bayern Muncheni do të përballen për herë të 28-të në historitë e tyre. Këtë herë këto dy skuadra gjigante të Evropës përballen në kuadër të ndeshjes së dytë të gjysmëfinaleve në Ligën e Kampionëve. Siç dihet, përballja e parë e zhvilluar një javë më parë në Gjermani përfundoi 2-2. Vinicius Junior kaloi në epërsi Realin në ndeshjen e parë, derisa Leroy Sane barazoi shifrat në 1-1. Harry Kane nga penalltia kaloi Bayernin në epërsi, derisa barazoi shifrat po ashtu nga penalltia. "E gatshme për të dhënë më të mirën, siç e meritojnë gjysmëfinalelet. Jemi shumë

entuziastë, sepse kemi mundësinë e madhe për të arritur një finale, por duke marrë parasysh vështirësitë që mund të hasim. Jemi shumë të motivuar dhe do të përpiqemi të bëjmë më mirë se ata nesër. Si klube jemi të ngjashëm, e komentuam që nga Munchen, ata kanë një traditë të madhe, histori dhe shumë suksese në Ligën e Kampionëve. Ne e respektojmë njëri-tjetrin dhe është e drejtë që të jetë kështu. Në një gjysmëfinale duhet ta respektosh kundërshtarin dhe gjithashtu sepse ata bënë më mirë se ne në ndeshjen e parë", ka deklaruar Carlo Ancelotti, trajner i Real Madridit.

Real pas kësaj ndeshje e mposhti Cadizin (3-0) dhe siguroi titullin në La Liga, një sukses mjaft i madh



për djelmohat e Carlo Ancelottit, ky titull është i 36-ti në historinë e Realit. Ndryshe nga Reali, Bayerni tashmë e ka humbur garën për titull të kampionit në Bundesliga dhe në fundjavë ka pësuar humbje

nga Shtuttgarti (3-1). Lajm i mirë për Real Madridin, rikthimi i portierit Thibaut Courtois, por edhe në këtë ndeshje titullar pritet të jetë Andriy Lunin që ishte ndër më meritoret për barazimin që

"mbretërit" e arritën në "Allianz Arena". Klubit spanjoll i rikthehet edhe Dani Carvajal, kurse mungesa e vetme është David Alaba. Bayerni në këtë ndeshje do të jetë pa Raphael Guerreiro, Eric Dier dhe Kingsley Coman, ndërsa pritet të rikthehet mbrojtësi holandez Matthijs de Ligt.

### FORMACIONET E MUNDSHME:

**Real Madrid:** Courtois; Carvajal, Rudiger, Nacho, Mendy; Valverde, Tchouameni, Kroos; Bellingham; Rodrygo, Vinicius Junior.

**Bayern Munchen:** Neuer; Kimmich, Dier, De Ligt, Mazraoui; Goretzka, Laimer; Sane, Musiala, Gnabry; Kane.

# Hyseni për herë të gjashtë rrëmben çmimin 'Ylli i javës'



**PODUJEVË, 7 MAJ** - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 32-të në Albi Mall Superligë i është dhënë futbollistit të KF Llapi, Muhamet Hyseni. Kjo është hera e gjashtë në këtë edicion që ai kurorëzohet me këtë çmim. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Blerim Havolli, Lulzim Rrmoku dhe Agim Xhakolli. Ky

komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e 32-të t'i takojë Muhamet Hysenit pasi ai realizoi dy gola dhe një asistim, duke qenë më meritori që Llapi fitoi ndaj Feronikelit 74 (3:2) dhe mbeti në garë për titull. Pasi mori këtë çmim Hyseni u shpreh i lumtur që sërish u vlerësua si më i miri i javës. "I lumtur për çmimin 'Ylli i javës' i cili është i gjashti për mua. Ky çmim padyshim është motiv shtesë për punë, fitore e çmime të radhës! Këtë çmim e ndaj me të

gjithë bashkëlojtarët. Pa bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre do të ishte vështirë të shënoja dhe golat e mi të ishin përcaktues në fitoret e skuadrës! Patjetër meritë e suksesit tim dhe e skuadrës është stafi i trajnerëve që po bëjnë punë shumë profesionale, punë e cila dëshmohet me fitoret në vazhdimësi. Besoj se ky është vetëm fillimi i një rrugëtimi të suksesshëm për mua dhe për KF Llapi", ka thënë Hyseni.

## Orari i finaleve në Superligën e Basketbollit

**MITROVICË, 7 MAJ** - Të enjten zyrtarisht fillon "beteja" në mes të Trepçës dhe Golden Eagle Yllit për titullin kampion. Skuadra që shënon tri fitore do të shpallet kampione. Ndeshja e parë zhvillohet në Mitrovicë, derisa mund të zhvillohen deri në pesë sfida. Mitrovicasit

përfunduan edicionin e rregullt në vendin e parë me 25 fitore e tri humbje, kurse therandasit në vendin e tretë me 19 fitore e nëntë humbje. Nga tri humbjet "Xehetarët", dy kanë ardhur nga therandasit në garat e rregullta. Këto dy skuadra ishin takuar në finale të Ligës Unike, që përfundoi

me fitoren e mitrovicasve në një sfidë dramatike 66:67. Trepça ka fituar Kupën dhe Superkupën dhe është në kërkim të trofeut të katërt për këtë edicion. Në anën tjetër, therandasit duan ta rikthejnë titullin në qytetin e tyre dhe ta fitojnë atë për herë të tretë në histori.

### ORARI I FINALEVE

- 9 maj  
19:00 Trepça - Golden Eagle Ylli
- 12 maj  
19:00 Golden Eagle Ylli - Trepça
- 16 maj  
19:00 Trepça - Golden Eagle Ylli
- 19 maj  
19:00 Golden Eagle Ylli - Trepça (e mundshme)
- 23 maj  
19:00 Trepça - Golden Eagle Ylli (e mundshme)



## Wolff: Jemi gati të presim disa muaj Verstappenin

Stuttgart, 7 maj - Në vitin 2025, siç dihet prej disa muajsh, rrugët e Lewis Hamiltonit dhe Mercedesit do të ndahen. Toto Wolff shpjegoi asokohe se ai nuk ishte me nxitim për ta zgjedhur zëvendësuesin e tij dhe bota e paparashikueshme e Formula 1 i dha atij mundësinë për të

përfshirë Max Verstappenin në mesin e kandidatëve të mundshëm. Rruga për ta sjellë kampionin holandez të "shigjetat e argjenda" duket të jetë gjithçka tjetër veçse e qetë. Nga njëra anë, Verstappen mund të dëshirojë ta ndryshojë skuadrën për shkak të mosmarrëveshjeve të

brendshme brenda Red Bullit. Nga ana tjetër, Mercedesi nuk duket se ka një makinë shumë konkurruese për holandezin. Toto Wolff, pas garës së Majemit, foli sërish për këtë çështje, duke sqaruar: "Në jetë nuk ka asgjë 100 % të sigurt. Ne do të presim dhe do të shohim se çfarë do të bëjë Max

për të ardhmen e tij. Natyrisht që po monitorojmë edhe pilotët e tjerë. Carlos Sainz ishte përsëri shumë i shpejtë. Jemi në modalitetin e vëzhgimit. Vendimi për të ardhmen e tij i takon Maxit dhe nuk do të jetë çështje ditësh, por javësh apo muajsh. Ne do të presim".



## Tare pasi merr çmimin drejtori më i mirë sportiv: Nuk rikthehem te Lazio

ROMË, 7 MAJ - Igli Tare është vlerësuar në "Gran Gala del Calcio" duke marrë çmimin "Drejtori më i mirë" për sezonin e shkuar. Në eventin e organizuar nga Adiscop, ish-futbollisti i kombëtares foli për të kaluarën e tij te Lazio duke theksuar se nuk do të kthehet më në klubin kryeqytetas. Sa i takon të ardhmes, Tare u shpreh i hapur për oferta, duke u shprehur se një shumë gjuhë të huaja dhe mund të punojë në shumë vende.



Lazios që të ketë një të ardhme edhe më të ndritur.

- Pas ikjes tuaj, Lazio nuk po ia del të klasifikohet në vendet e para të klasifikimit...

**Tare:** Nuk mendoj se rezultatet e Lazios kanë lidhje me largimin tim, vitin e kaluar e merituar vendin e dytë. Por, nuk erdhi si një e papritur pasi për ato rezultate ishte punuar shumë nga drejtuesit dhe trajnerët. Unë i uroj

A ju ka bërë të ndiheni më mirë kjo pauzë?

**Tare:** E kisha menduar prej kohësh dhe e kisha biseduar edhe me president Lotiton. Të bën mirë, i sheh gjërat nga një tjetër këndvështrim dhe mbi të gjitha ke më shumë kohë për familjen. Jam gati t'i rikthehem sërish detyrave, do të mbetem gjithnjë i lidhur me

Lazion, por dua një rrugëtim tjetër.

Ku do t'ju pëlqente të punonit?

**Tare:** Kam dëgjuar që flitet për rikthimin te Lazio, por unë nuk i besoj rikthimeve. Rrugët janë të ndara dhe klubi ka bërë zgjedhje të tjera. Nuk do të kthehem aty në të ardhmen e afërt. Pastaj sa i takon klubit të radhës, kam fatin që flas shumë gjuhë dhe dua një projekt që të më intrigojë.

Çfarë këshille do t'i jepnit një drejtori të ri sportiv?

**Tare:** Unë kam menduar gjithnjë që të bëja maksimumin me aq mundësi ekonomike sa kishim. Ndonjëherë shkon mirë dhe ndonjëherë jo. Por, duke parë punën e 15 viteve të fundit te Lazio, mendoj se kam bërë mirë bashkë me presidentin dhe bashkëpunëtorët e tjerë.

## Minnesota shkatërron kampionët e Denverit, New Yorku fiton gjysmëfinalen e parë ndaj Indianas

NYU-JORK, 7 MAJ - Tjetër zhgënjim për kampionët e Denverit, që në fushën e tyre u mundën me rezultat 106-80 nga Minnesota. Kjo e fundit i fitoi të dyja takimet jashtë fushës dhe tashmë udhëheq 2-0 serinë e gjysmëfinaleve të "play-off" në Konferencën e Perëndimit. Ndashje e komanduar nga miqtë, ku Towns dhe Edwards realizuan



nga 27 pikë secili për Minnesotan. Vendimtar edhe stoli i ekipit mik, nga ku erdhën 37 pikë. Për Denverin zhgënjyjen lojtarët "big", me Gordon që realizoi 20 pikë e Jokiçi vetëm 16 pikë. Ka filluar seria e gjysmëfinaleve edhe në

Konferencën e Lindjes, ku New Yorku mundi me shifrat 121-117 Indianan dhe udhëheq 1-0 me ndeshje. Të gjithë titullarët e ekipit nju-jorkez realizuan mbi 13 pikë, ku shkëlqeu Jalen Brunson me 43 pikë.

### KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

New York - Indiana 121-117 (1-0)  
Boston - Cleveland

### KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Denver - Minnesota 80-106 (0-2)  
Oklahoma - Dallas

## Roma e dëshiron Chiesan, Juve i ofron kontratë të re

Juventus është gati t'i ofrojë Federico Chiesan një kontratë të re, të paktën deri në 2026, ndërkohë kontrata e tij aktuale skadon më 2025, raporton "La Gazzetta dello

Sport". Kjo më shumë shihet si një lëvizje për të mos e humbur me parametra zero në përfundim të sezonit të ri. Chiesa ka pasur gjithnjë admirues, mbi të gjitha

jashtë Serisë A por, së fundmi, sipas mediumit në fjalë, interesim për të ka shfaqur edhe Roma. Daniele De Rossi është një admirues i zjarrtë i Chiesan, e pëlqente shumë edhe

përpara se sulmuesi të dhuronte atë paraqitje në kryeqytet. Gjithnjë sipas "Corriere dello Sport", është e vështirë që Juve të lë të lirë një nga sulmuesit më të mirë italian të

brezit të tij, pavarësisht se kush do të jetë trajneri i "Zonjës së Vjetër" sezonin e ri, për këtë arsye po nxiton për t'i ofruar një kontratë të re.

### SHKURT

#### Daku në formacionin e javës në Rusi

Mirlind Daku ka vazhduar shkëlqimin në elitën e futbollit rus me skuadrën e tij Rubin Kazan. Sulmuesi gjilanas ka shënuar sërish. Edhe kësaj radhe goli i tij ka qenë vendimtar për t'i siguruar skuadrës së tij një pikë të rëndësishme. Daku ishte vendimtar duke shënuar në minutat shtesë për t'i siguruar Rubin Kazanit një pikë të madhe në barazimin 2-2 në udhëtim te CSKA Moska. Falë paraqitjes fantastike dhe golit të shënuar, Mirlind Daku ka zënë vend në formacionin e javës së 27-të në elitën e futbollit rus. Deri më tani Daku ka shënuar tetë gola dhe ka asistuar në katër të tjerë, duke qenë një nga sulmuesit më të mirë në Superligën e Rusisë. Formacioni (3-4-3): Nigmatullin, Perez, Duarte, Chernov, Ishkov, Litvinov, Claudinho, Ngamaleu, Daku, Tyukavin, Bitello.

#### Ten Hag pas debaklit nga Crystal Palace: Jam trajneri i duhur për t'i ndryshuar gjërat

Manchester Unitedi ka pësuar debakël në udhëtim te Crystal Palace pasi është mposhtur me rezultat të thellë 4-0. "Djajtë e Kuq" tani rrezikojnë të mbesin jashtë garave evropiane, pasi kanë një orar të vështirë në tri xhirot e fundit. Unitedi do të luajë ndaj Arsenalit, Newcastle Unitedit dhe Brightonit. Përkundër debaklit të pësuar në Londër, Erik Ten Hag vazhdon të thotë se ai është trajneri i duhur për ta nxjerrë Manchester Unitedin nga kjo situatë. "Unë jam trajneri i duhur për t'i ndryshuar gjërat. Nëse të gjithë lojtarët janë në dispozicion atëherë ne kemi një skuadër të mirë. Por nëse mungon e gjithë prapavija atëherë ne jemi në probleme të mëdha", ka deklaruar Ten Hag. Unitedi aktualisht ndodhet në pozitën e tetë në tabelë me 54 pikë, sa ka edhe Chelsea në pozitën e shtatë që i dërgon në Ligën e Evropës.

#### Mourinho dëshiron të rikthehet në 'Old Trafford', Unitedi del kundër

Jose Mourinho i ka shprehur klubit të Manchester Unitedit dëshirën për t'i menaxhuar sërish "djajtë e kuq". Lajmi është konfirmuar nga "Manchester Evening News", që ka marrë edhe mendimin e klubit, që duket se nuk dëshiron ta riemërojë portugezin në stolin e "Old Trafford", duke i besuar ende Erik ten Hag. Mësohet se trajneri portugez 61-vjeçar u ka thënë të besuarve se është gati të rikthehet në Manchester për ta menaxhuar Unitedin për herë të dytë në karrierën e tij, pasi u shkarkua nga klubi në dhjetor 2018. Interesimi i Mourinhos vjen pak orë pasi "djajtë e kuq" pësuan një humbje poshtëruese 4-0 ndaj Crystal Palaces. Mourinho u bë trajner i Manchester Unitedit në maj 2016, klub me të cilin fitoi Europa League dhe Kupën e Ligës në dy vjet e gjysmë në detyrë. Aktualisht i papunë, pas shkarkimit nga Roma në janar, thuhet se Jose Mourinho është mik i bashkëpunuarit të Unitedit, Sir Jim Ratcliffe. Gjithsesi, klubi duket se nuk ka dëshirë ta rikthejë.



### KONKURS – Për punonjës/e të AMIK

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-175, për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (AMIK), shpall:

#### KONKURS

Për punonjës/e të AMIK

**Numri i referencës: 01- AMIK-21/2024**

Nivelet e pagave: Të klasifikuara

Orari i punës: I plotë

Kohëzgjatja e kontratës: E pacaktuar

Vendet e punës: AMIK

#### Konkursi shpallet në fushat:

Verifikim të Sigurisë;

Burime Njerëzore;

IT, programim.

#### Kualifikimet dhe kushtet e përgjithshme për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit:

Kandidatët për fushën 1 duhet të kenë përgatitje universitare;

Kandidatët për fushën 2 duhet të kenë përgatitje universitare si dhe trajnime në fushën përkatëse;

Kandidatët për fushën 3 duhet të kenë përgatitje universitare apo arsimim të mesëm dhe njohuri të thella në fushën IT-së të dëshmuar me certifikatë përkatëse;

Për fushën 2 dhe 3 përparësi kanë kandidatët që kanë përvojë pune;

Për fushat e lartëcekura përparësi kanë kandidatët që kanë njohuri në gjuhën angleze dhe serbe.

#### Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për punësim në AMIK si më poshtë:

Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;

Të jenë mbi moshën 18 vjeçare;

Të kenë kualifikimet e duhura arsimore dhe profesionale;

Ndaj tyre të mos jetë marrë masa përfundimtare e përjashtimit nga puna për shkak të kryerjes së shkeljes së rëndë disiplinore për dhënien e informacionit;

Të mos jetë i dënuar për vepra penale të kryer me dashje, me vendim të formës së prerë;

Kandidatëve i'u kërkohen certifikata nga Gjykata dhe Policia e Kosovës për të kaluarën e tyre penale;

#### Kalimi me sukses i procedurave të rekrutimit.

Kandidatët për punësim në AMIK do t'i nënshtrohen ekzaminimit mjekësor, verifikimit të sigurisë si dhe mund t'u nënshtrohen edhe kushteve tjera specifike.

Të gjithë kandidatët të cilët deklarojnë të dhëna të pa sakta, të rrejshme, kurdo që zbulohet gjatë procesit të rekrutimit apo verifikimit të sigurisë eliminohen.

Përveç kushteve të mësipërme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe standardet strikte të sigurisë të parapara në Ligjin Nr.08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar.

#### Procedura e përzgjedhjes:

Procesi i brendshëm i përzgjedhjes është i klasifikuar dhe përbëhet nga disa faza të selektimit dhe testimit. Përzgjedhja e kandidatëve për pozitat përkatëse do të bëhet varësisht prej kualifikimeve, bazuar në kriteret dhe kushtet e përgjithshme të përshkruara në konkurs si dhe kriteret dhe kualifikimet tjera specifike të brendshme.

Kohëzgjatja e punësimit:

Punësimi në AMIK është me afat të pacaktuar, pas përfundimit me sukses të periudhës provuese, bazuar në Ligjin për AMIK, rregullat dhe procedurat e brendshme.

#### Procedura e aplikimit:

Dokumentacioni për aplikim duhet të përmbajë:

Formularin zyrtar të aplikimit (Aplikacionin);

Kopjet e dëshmimeve për përfundim të studimeve të lëshuara nga institucionet arsimore (për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit diploma duhet të jetë e nostrifikuar);

Certifikatat e trajnimeve apo formave tjera të aftësisë profesionale (nëse kanë);

Dëshmi për përvojën e punës dhe kualifikimet tjera;

Jetëshkrimi – CV;

Letër motivuese, pritjet nga vendi i punës dhe qëllimet e karrierës;

Certifikata e lindjes/ekstrakti i lindjes;

Kopja e letërnjoftimit/pasaportës (të jenë valide);

Një fotografi të formatit 5×5 (jo më e vjetër se 6 muaj);

Certifikata nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar (e lëshuar nga Gjykata, jo më e vjetër se tre muaj).

Aplikimi bëhet vetëm në mënyrë elektronike në web faqen zyrtare të AMIK [www.amik-rks.org/konkursi](http://www.amik-rks.org/konkursi) duke plotësuar aplikacionin dhe bashkangjitur dokumentet e kërkuara për punësim.

#### Data e mbylljes së konkursit:

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit në mjete të informimit, përkatësisht nga data 03.05.2024 deri me datën 17.05.2024.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar më lartë nuk pranohen, kurse aplikacionet e mangëta/të pa kompletuara refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për fazat e mëtejme do të kontaktohen.

Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar ofron mundësi të barabarta për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e interesuar.

Aplikimi nga ana juaj të jetë diskret.

**Për çdo paqartësi mund të na kontaktoni në numrin e telefonit: (+383) 044 60 60 40.**

## Thirrja për aplikim (DHËNJE TË OFERTËS)

“SUAD KOXHA” B.I. me numer Unik:811241512 me seli në fshati Doganaj p.n. Komuna Kaqanik ( Vend Investim Fshati Koxhaj- Komuna Kaqnik) me pronar SUAD KOXHA, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për mallrat/punët/shërbime këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre Puneve dhe materialit Ndërtimor:

1. Ndërtimi i Shtallës me Dhomen e qumështit për Dele 35x12 m
2. Ndërtimi i Gropës septike(pleh) të ngurt 10x5x0-1.6 m
3. Ndërtimi i Hangarit 14 x 7 x 5 m

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek “SUAD KOXHA” B.I. (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë (5 ditë nga data e publikimit)

Afati i dorezimit të Ofertave 10 ditë nga data e pranimit te ftesave per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: fshati Doganaj p.n. Komuna Kaqanik  
Për Informata Shtesë tel: +383 44 977 098 dhe në email adresën: [parku@hotmail.com](mailto:parku@hotmail.com)



### KONKURS – Za radnika/radnicu AZKI

Na osnovu Zakona br.08/L-175, Zaštiti Klasifikovanih Informacija (AZKI), objavljuje:

#### KONKURS

Broj reference: 01-AZKI-21/2024

Nivo plate: Klasifikovano

Radno vreme: Puno

Trajanje ugovora: Neodređeno

Radna mesta: AZKI

#### Konkurs se objavljuje u oblastima:

Bezbednosna provera;

Ljudski resursi;

IT, Programiranje;

#### Opšti kriterijumi i uslovi za učešće u procesu regrutovanja:

Kandidati za 1. oblast moraju imati visoku stručnu spremu;

Kandidati za 2. oblast moraju imati visoku stručnu spremu i obuku u relevantnoj oblasti;

Kandidati za 3. oblast moraju imati visoku stručnu spremu ili srednje obrazovanje i duboko znanje iz oblasti informacionih tehnologija, dokazano odgovarajućim sertifikatom;

Prednost imaju kandidati za 2 i 3 koji imaju radno iskustvo;

Prednost imaju kandidati koji poznaju engleski i srpski jezik.

Kandidati moraju ispuniti opšte uslove za zapošljavanje u OAK, a to su:

Da su državljani Republike Kosova;

Da su stariji od 18 godina;

Da imaju odgovarajuće obrazovne i stručne kvalifikacije;

Da se nad njima nisu preduzele mere otpuštanja ili izuzeća sa posla u AZKI ili u drugim institucijama slične prirode;

Namjerno ne razočarati zbog lošeg krivičnog djela, odlukom prve formacije;

Kandidati moraju imati potvrdu Suda pravde i Kosovske policije o svojoj prošlosti i osudama;

#### Uspešan prolazak procedura regrutacije.

Kandidati za zapošljavanje u AZKI će biti podvrgnuti lekarskom pregledu, verifikaciji bezbednosti i mogu biti podložni drugim posebnim uslovima.

Svi kandidati koji navedu netačne podatke će biti diskvalifikovani za vreme procesa verifikacije bezbednosti.

Pored gore navedenih uslova, kandidati moraju da ispune stroge bezbednosne standarde navedene u Zakona br.08/L-175, Zaštiti Klasifikovanih Informacija.

#### Postupak selekcije:

Unutrašnji proces selekcije je klasifikovan i sastoji se od nekoliko faza selekcije i testiranja. Izbor kandidata za odgovarajuće pozicije vršiće se u zavisnosti od kvalifikacija, na osnovu kriterijuma i opštih uslova opisanih u konkursu, kao i drugih specifičnih internih kriterijuma i kvalifikacija.

#### Trajanje zaposlenja:

Zaposlenost u AZKI-u je na neodređeni rok, nakon uspešnog završetka probnog perioda, na osnovu Zakona o AZKI, internih pravila i procedura.

#### Proces apliciranja:

Zainteresovani kandidati moraju popuniti zahtev za zaposlenje i priložiti sledeća dokumenta ili dokaze:

kopije dokaza za završetak studija koje izdaju obrazovne ustanove (za kandidate koji su završili obrazovanje u inostranstvu diplome moraju biti nostrifikovani), kao i ostale kvalifikacije, potvrde o obuci ili drugim oblicima stručnog osposobljavanja (ako ih ima);

Dokaz o radnom iskustvu i drugim kvalifikacijama;

CV i motivaciono pismo;

Prpratno pismo, očekivanja od radnog mjesta i ciljevi karijere;

izvod iz matične knjige rođenih/rodni list ili kopiju lične karte/pasoša (važeće);

fotografiju formata 5×5 (ne stariju od jednog meseca);

potvrdu iz evidencije osoba protiv kojih se vodi krivični postupak i osuđenih lica (izdata od Suda, ne starija od tri meseca).

Aplikacija se vrši samo elektronskim putem na zvaničnoj web stranici AZKI <https://amik-rks.org/konkursi/?lang=srp>, popunjavanjem aplikacije i prilaganjem tražene dokumentacije.

#### Datum zatvaranja konkursa:

Konkurs će biti otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja, odnosno od datuma 03.05.2024 do datuma 17.05.2024.

Aplikacije podnesene nakon navedenog roka se ne prihvaćaju, dok nepotpune/nekompletirane aplikacije se odbijaju.

Samo odabrani kandidati za sledeću fazu će biti kontaktirani.

Agencija za Zaštiti Klasifikovanih Informacija pruža jednake mogućnosti svim državljanima Republike Kosova i pozdravlja prijave svih zainteresovanih osoba.

Apliciranje mora biti diskretno.

**Za sve nejasnoće kontaktirajte nas na broj telefona: (+383) 044 60 60 40.**



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




[www.facebook.com/gjeipuneshejte](https://www.facebook.com/gjeipuneshejte)

## RESTAURANT

---

# SWISS

## TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5 paragrafi 1, dhe neni 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT – Nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullorës Nr.01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A, Vendimin e dates 07.05.2024 me numër të protokollit nr.2052 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A në Prishtinë:

### VAZHDON AFATI I KONKURSEVE

Të Publikuara nga data 20.04.2024 deri më 04.05.2024 për pranimin kandidatëve në pozitat vijuese në KRM “Pastrimi” SH.A:

1. “Drejtues i Departamentit të Burimeve Njerëzore” (1) pozitë.
2. “Udhëheqës i Zyrës Ligjore (1) pozitë”
3. “Udhëheqës i Njësisë për Regjistrimin e Klientëve dhe Monitorimin e Regjistrimit të Klientëve” (1) pozitë
4. “Operator për Thirrje për Amvisëri, Biznese dhe Shërbim nga Konsumatori” (3) pozita
5. “Përgjegjës për Protokoll dhe Arkivë” (1) pozitë.
6. “Zyrtar i Lartë i Zyrës për Koordinim me Njësitë Operative” (1) pozitë
7. “Zyrtar Mbështetës për Administratë dhe Financa” (1) pozitë
8. “Elektricitist i Objektivit” (1) pozitë

Afati për paraqitjen e aplikacioneve vazhdohet për 5 (pesë) ditë duke filluar nga data 08.05.2024 deri më date 13.05.2024 si dhe kriteret në Konkurs mbeten të njëjta si dhe aplikantët të cilët kanë konkuruar në këto konkurse nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri.

KRM “PASTRIMI” SH.A



Prema çlanu 8 Zakona br. 03/L-212 o radu, član 5 stav 1, i član 7 Upravnog uputstva MFPT – br.01/2024 o regulisanju postupka konkursa u javnom sektoru, Uredba br.01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RM “Čišćenje”. A, Odluka od 07.05.2024. godine sa brojem protokola br. 2052 glavnog izvršnog direktora RM “Čišćenje” SH. A u netaknutom:

### ROK TAKMIČENJA SE NASTAVLJA

Objavljeno od 20.04.2024 do 04.05.2024. godine za prijem kandidata na sledeće pozicije u KRM “Čišćenje” SH. A:

1. "Šef Odeljenja za ljudske resurse" (1) pozicija.
2. "Pozicija šefa Pravne kancelarije (1) "
3. "Šef Jedinice za registraciju i praćenje registracije klijenata" (1) pozicija
4. "Operator za pozive za domaću, poslovnu i korisničku službu" (3) pozicija
5. "Odgovoran za protokol i arhivu" (1) pozicija.
6. "Viši službenik Kancelarije za koordinaciju sa operativnim jedinicama" (1) pozicija
7. "Službenik za podršku administraciji i finansijama" (1) pozicija
8. "Objekat električar" (1) pozicija

Rok za podnošenje prijave produžava se na 5 (pet) dana od 08.05.2024. do 13.05.2024. godine i kriterijumi na Konkursu ostaju isti i podnosioci zahteva koji su se takmičili na ovim konkursima nisu u obavezi da se ponovo prijave.

KRM "PASTRIMI" SH. A





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

